

# Anestezi pediatrike



# Lënda

Llojet e anesteziës	3
Anestezi e përgjithshme	4
Anestezi rajonale, anestezi kaudale specifike	7
Informacion shtesë	9
Formulari i regjistrimit	9
Konsultë	9
Intervistë telefonike	10
Para ditës së kirurgjisë	10
Në shtëpi pas ndërhyrjes	10
Shënime të përgjithshme mbi medikamentet	10
Faturimi	10
Për ne ka rëndësi të mbeteni të kënaqur	10



## Udhëzime agjërimi

Në ditën e operacionit, mund të konsumohen ushqime të ngurta (përfshi çamçakëz, karamelle etj.) dhe bulmetra ose lëngje të tjera të patejdukshme **vetëm deri në 6 orë para shtrimit në spital**. Lëngje të tejudkshme të ëmbëlsuara si çaj, shurup dhe ujë mund të konsumohen **deri në një 1 orë para shtrimit të planifikuar në spital**. **Pas kësaj nuk duhet konsumuar më asgjë**. Nëse nuk i ndiqni këto udhëzime, përballeni me rrezikun që fëmija të vjellë dhe e vjella t'i hyjë në mushkëri. Kjo mund të çojë në pneumoni që kanos jetën.

**Këto udhëzime duhet të ndiqen me rreptësi.**



## Të dashur prindër, i dashur pacient

Është caktuar një ndërhyrje kirurgjike për ju ose fëmijën tuaj. Për ta kryer me sukses dhe pa dhimbje operacionin, do të përdoret anestezi. Si hap i parë, dëshirojmë t'ju japim tani informacion mbi këtë temë. Kjo ju lejon të kuptoni më mirë se çfarë të prisni, qoftë ju apo fëmija juaj, dhe ju lë me mendje të qetë.

Brenda kontekstit të intervistës telefonike ose konsultës për anestezi, anesteziologu do të diskutojë me ju se ç'loj anestezie është më mirë për ndërhyrjen në rastin tuaj.

## Llojet e anesteziës

Në parim, ka dy lloje anestezie:

**\_ Anestezi e përgjithshme**

**\_ Anestezi rajonale**

Në këtë broshurë, përshkruajmë **anestezinë e përgjithshme** dhe **anestezinë kaudale që përdoret në ndërhyrjet urologjike (anestezi e rajonale)**.



## Anestezi e përgjithshme

Anestezia e përgjithshme është gjendje e ngjashme me gjumin e thellë.

Për fëmijët, përdoret një gaz anestetik me anë të një maske fytyre deri sa të arrihet gjendja e gjumit. Vetëm pas kësaj kryhet hyrja në vena në mënyrë që anestezia të vazhdohet me medikamente që jepen me anë të serumit. Prindërit inkurajohen të qëndrojnë me fëmijën e tyre deri kur ai ose ajo të ketë rënë në gjumë.

Gjatë fazës së rënies në gjumë, shpesh fëmijët shfaqin lëvizje ndaj të cilave nuk janë të vetëdijshëm (lëvizje të pavullnetshme).

Për adoleshentë dhe të rritur, hyrja në vena kryhet ndërkohë që janë zgjuar. Pas injeksionit të narkozës/anestetikut (medikamenti që shkakton pavetëdijen artificiale) gjumi arrihet brenda afërsisht 30 sekondash.

Gjatë anestesisë së përgjithshme, duhet mbështetur frymëmarrja. Gjatë ndërhyrjeve me kohëzgjatje të shkurtër, kjo mund të arrihet me maskë fytyre. Për procedura me kohëzgjatje më të gjatë, ose nëse e kërkon vetë operacioni, ajrimi i pacientit sigurohet nëpërmjet vendosjes së maskës laringiale, ose futjes së një tubi të hollë përmes gojës - ose përmes hundës, siç ndodh shpesh në procedurat dentare - brenda trakesë (intubimi). Kështu, ajri i pasuruar me oksigjen mund të jepet në mënyrë të vazhdueshme dhe të mjaftueshme me anë të maskës së fytyrës, maskës laringiale, ose tubit.

Në fund të ndërhyrjes, dhënia e narkozës/anestesisë ndalohe, dhe fëmija zgjohe brenda disa minutash. Aty a tutje, fëmija monitorohet deri kur të ndihet aq mirë sa për t'u liruar nga spitali. Fëmija duhet shoqëruar për në shtëpi nga një i rritur.



### **\_ Siguria e anestezisë së përgjithshme**

Anestezia moderne është shumë e sigurt dhe paraqet fare pak rreziqe. Të gjitha funksionet jetike siç janë frymëmarrja, qarkullimi, dhe funksioni kardiak monitorohen vazhdimisht nga ekipi anesteziologjik. Prandaj incidentet ose ndërlikimet me rëndësi janë shumë të rralla në të gjitha procedurat moderne. Rreziqet e shoqëruara me anestezinë e përgjithshme varen së pari nga mosha, stili i jetës, si dhe sëmundjet e mëparshëm të pacientit si dhe lloji i kirurgjisë dhe kohëzgjatja e ndërhyrjes.



### **\_ Efektet anësore dhe ndërlikimet e përgjithshme**

**Me raste, mund të shfaqen ndërlikimet në vijim:**

- \_ Hematomë (shenjë e nxirë) në zonën e futjesë tubit / hyrjes në vena për serum
- \_ Vështirësi në gëlltitje ose ngjirje të lehtë për shkak të intubimit
- \_ Acarim/dëmtim i mukozës me gjakrrjedhje nga hundët ose në fyt për shkak të intubimit përmes hundës (intubimit nazal)
- \_ Ndjesi të ftohti, dridhmash

**Në raste të rralla, mund të ndodhin ndërlikimet në vijim:**

- \_ Përzierje dhe të vjella: megjithëse përzierjet dhe të vjellat janë të rralla me agjentët anestezikë që përdoren sot, ekziston një shkallë e vogël rreziku për këto simptoma, pasi gjaku mund të futet në stomak gjatë një ndërhyrjeje në zonën nazofaringiale. Kjo ka mundësi të çojë në të vjella. Në përgjithësi, pacienti ndihet mirë pasi të vjellë një herë dhe vetëm në raste të rralla ndodh të vjellë sërish.



### **Në raste të rralla, mund të ndodhin ndërlikimet në vijim:**

- Të vjella gjatë induksionit anestezik: gjatë rrjedhës së kësaj procedure, ekziston rreziku që acidet nga stomaku të hyjnë në mushkëri dhe të zhvillohet pneumoni. Ky ndërlikim mund të ndodhë nëse udhëzimet për agjërime (ju lutemi të shihni faqen 3) nuk ndiqen me rreptësi dhe, si pasojë, stomaku nuk është zbrazur. Ka rëndësi të vihet re se gëlltitja e lëngjeve të tejdukshme (çaj me sheqer, shurup, ujë) deri në 1 orë para shtrimit në spital promovon zbrazje optimale të stomakut dhe mbështet ekuilibrin e lëngjeve.
- Hiperndjeshmëria ose reaksionet alergjike ndaj narkozës, anestetikëve, anestetikëve lokalë, të tjera medikamenteve të përdorura, ose artikujve prej lateksi: këto mund të shfaqen në formë pruriti (kruarje), shpërthim puçrrash, ënjtje buzësh ose fytyre, rënie e tensionit të gjakut, ngadalësim i rrahjeve të zemrës, ose qëndron dhe mundësia e një krize astmatike, dhe trajtohen menjëherë nga ekipi i anesteziologjisë.
- Dëmtim lëkure ose nervash: shtypja ose tërheqja gjatë vënies në pozicion të pacientit mund ndikojë nganjëherë negativisht funksionin nervor, ose – në raste shumë të rralla – të rezultojë në një cen të përhershëm.
- Dëmtim i bajameve faringiale: kjo është e mundur gjatë tejçimit të intubimit hundor, veçanërisht te fëmijët.



### **\_ Historia e sëmundjes dhe sëmundjet e mëparshme**

Historiku i pacientit jep informacion me rëndësi mbi sëmundje serioze specifike, disa sëmundje gjenetike, dhe të tjerë faktorë ndërlikues. Ky informacion i lejon ekipit të anestezisë të modifikojë proceset dhe medikamentet anestezike, si dhe tërë infrastrukturën siç e do rasti. Në rast ndërhyrjeje me zgjedhje, kirurgjia mund të shtyhet ose anulohet e tëra. Kjo zbatohet edhe për mos-përputhje me rregullat e agjërimit ose udhëzime të tjera nga mjeku.

### **Efekte specifike, por të rralla, anësore dhe ndërlikime të lidhura me anestezinë e përgjithshme:**

- Dëmtime të shkaktuara në dhëmbë gjatë intubimit - veçanërisht në dhëmbët e sipërm prerës - dhe në punime dentare janë shumë të rralla.
- Ndikim negativ në frymëmarrje dhe ajrimi gjatë anestezisë mund të ndodhë për shkak të një sëmundjeje të mëparshme dhe varet nga sa e rëndë ka qenë sëmundja. Kjo ka rëndësi të veçantë në rastin e fëmijëve, pasi i kanë rrugët e frymëmarrjes shumë të ndjeshme ndaj sëmundjeve të mëparshme (e ftohur, kollë, bronkit) dhe mund të ngushtohen direkt nga manipulimi (p.sh. induksioni anestezik, intubimi, acarues të tjerë të jashtëm). Në raste sëmundjesh akute dhe gjendjesh të këqija shëndetësore të kaluara kohët e fundit, kirurgjia mund të shtyhet. Në rast sëmundjeje kronike të frymëmarrjes, është e rëndësishme të merret një epikrizë nga mjeku i familjes për vlerësimin e saktë të aftësisë së pacientit për t'iu nënshtruar anestezisë.
- Ndërlikimet që cilave u duhet patur frika siç janë dobësimi kardiak, qarkullimor ose mushkëror me dëmtim të mundshëm të organeve jetike, sidomos trurit, ose edhe vdekja, janë tepër të rralla në ditët e sotme. Në përgjithësi, shenjat e ndërlikimeve të mundshme kapen që herët, kështu që mund të shmangen.



## Anestezia rajonale

Anestezia rajonale ndryshon nga anestezia lokale. Në anestezinë lokale (AL), shuarja e dhimbjes arrihet përmes injeksionit të një medikamenti (anestetik lokal) në zonën e lidhur direkt me atë ku do të kryhet operacioni dhe në përgjithësi bëhet nga një kirurg. Në anestezinë rajonale, shuarja e dhimbjes arrihet përmes injeksionit të një anestetiku pranë një nervi ose rrjeti nervash. Në këtë mënyrë, ndjesia e dhimbjes fashitet vetëm në atë segment të trupit që po merr trajtimin kirurgjik.





**Anestezia rajonale për fëmijë përfshin në veçanti:**

## **Anestezia kaudale për ndërhyrje urologjike**

### **Zbatimi:**

për fëmijë, anestezia kaudale është procesi më i përdorur i anestezisë rajonale në mbarë botën për ndërhyrje poshtë mesit (ndërhyrje urologjike). Në këtë proces, injektohet një anestetik lokal në kanalin shpinor në nivelin e kërbishtës pas induksionit të anestezisë. Kjo siguron disa orë pakësimi dhimbjesh.

### **Rreziqet:**

Me të gjitha procedurat e anestezisë rajonale ka një rrezik efektshmërie të pamjaftueshme, për shembull, për shkak të shpërndarjes jo të plotë të anestetikut të injektuar. Nganjëherë, mund të zhvillohet një hematomë (shenjë e nxirë) në zonën e injeksionit, sidomos nëse pacienti vuan nga çrregullimi i mpiksjes së gjakut. Infeksionet, dëmtimet dhe dëmtimet nervave janë shumë të rralla. Po ashtu, edhe ndërlikimet kardiopulmonare dhe episode ngërçesh ndodhin tepër rrallë; monitorimi i vazhdueshëm i pacienteit nga ekipi anesteziologjik siguron një reagim të shpejtë ndaj këtyre situatave.



## Informacion shtesë



### \_ Formulari i regjistrimit

Ju lutemi të plotësoni formularin e regjistrimit për anestezinë - që ju është dhënë në format elektronik ose letër - dhe jepuni përgjigje të hollësishme pyetjeve mbi shëndetin. Për sëmundje të mëparshme dhe/ose kirurgji madhore të mëparshme, na duhet një raport me shkrim nga pediatri juaj. Duhet sqaruar gjendja e pasigurt shëndetsore para kirurgjisë. Kjo bëhet kryesisht për sigurinë e fëmijës suaj.



### \_ Konsulta

Nëse dëshironi të flisni me një nga anesteziologjistët tanë për konsultim para një ndërhyrjeje, ju lutemi të na kontaktoni:

» **Limmatklinik Zürich**

» **Zvicra veri-lindore dhe Zürich-Winterthur**

» **Zvicra Qendrore dhe Veriperëndimore**

» **Tessin**

» **Email**

Numër telefoni: 044 448 30 30

Numër telefoni: 052 320 01 20

Numër telefoni: 041 379 70 30

Numër telefoni: 091 980 44 04

[info-winterthur@narkose.ch](mailto:info-winterthur@narkose.ch)

Nëse një konsultë mbi anestezinë bëhet e domosdoshme në bazë të përgjigjeve tuaja në pyetësin shëndetësor ose nga kartelat e paraqitura nga mjeku i familjes/pediatri, do të marrim përsipër t'ju ftojme ju ose fëmijën për një takim me ne.



### **\_ Intervista telefonike**

Para ndërhyrje, anesteziologu do të diskutojë me ju anestezinë e planifikuar dhe do të ketë kënaqësinë t'ju përgjigjet pyetjeve që mund të kenë. Ju lutemi të mbani shënime. Mjeku do t'ju kontaktojë brenda dy ditësh para ndërhyrjes (nëse kirurgjia është planifikuar pas një kohe pushimi ose për të hënë, brenda dy ditësh para pushimit ose fundjavës).

Për ta bërë më të thjeshtë vënien në kontakt me ju, ju lutem shënioni se kur jeni të lirë në formularin e regjistrimit (kohën më të mirë për t'ju kontaktuar, numrin e telefonit/celularit, etj.)



### **\_ Para ditës së kirurgjisë**

Jepini fëmijës një shpjegim në përkatësi të moshës mbi ndërhyrjen e planifikuar. Informojeni fëmijën se mund të dalë me fasho nga operacioni; për procedura dentare, shpjegojini se do t'i ndihet goja ndryshe pas heqjes së një dhëmbi. Ju lutemi sillni me vete një lodër, biberon ose batanije që fëmija e ka të preferuarën e vet.

Që të mund të përqendroheni plotësisht te fëmija që po i nënshtrohet kirurgjisë, rekomandohet të planifikoni shërbim kujdesues për fëmijët e tjerë të familjes në ditën e kirurgjisë.



### **\_ Në shtëpi në 24 orët e para pas anesteziës**

Fëmija nuk duhet lënë vetëm në shtëpi, në mënyrë që në rast se del ndonjë çështje urgjence (për shembull, një përkeqësim i papritur shëndeti, dobësi ose marrje mendsh), të mund të siguroni ndihmë të menjëhershme.



### **\_ Shënime të përgjithshme mbi medikamentet**

Për vite me radhë, medikamentet që janë përdorur vazhdimisht në anestezi për të rritur u janë dhënë me sukses edhe fëmijëve, edhe pse prodhuesit e medikamenteve nuk i kanë miratur për përdorim te fëmijët. Përvoja mbarëbotërore deri tani tregon se këto medikamente mund të shpërndahen pa rrezik edhe për fëmijët. Megjithatë, rreziqe të panjohura deri tani nuk mund të përjashtohen krejtësisht.



### **\_ Faturimi**

Në përgjithësi, do të merrni një faturë veçan nga narkose.ch për anestezinë që është kryer, përveçse kur janë bërë të tjera plane me kirurgun, qendrën kirurgjike ose klinikën. Po të kenë ndonjë pyetje në lidhje me faturimin, ju lutemi të na kontaktoni në çdo kohë.



### **\_ Ka rëndësi për ne që të mbeteni të kënaqur**

Ju lutemi të na njoftoni nëse nuk keni mbetur i kënaqur me punën tonë apo të tjera aspekte të dala nga ajo. Përshtypjet tuaja na lejojnë të përmirësohemi vazhdimisht. Natyrisht, lavdërimet tuaja gjithashtu na motivojnë të bëjmë çmos.

Mund të na jepni përshtypje përmes telefonit, postës ose postës elektronike në adresat e renditura më poshtë. Ne përpiqemi të përpunojmë përshtypjet tuaja sa më shpejt që është e mundur, për t'ua kaluar informacionin personelit përkatës për kontroll cilësie dhe për t'ju kthyer përgjigje juve.

**Mund të kontaktoni narkose.ch në vendndodhjet në vijim:**

<p><b>narkose.ch</b> Huobmattstrasse 3 6045 Meggen / LU Tel.: 041 379 70 30 info-meggen@narkose.ch</p>	<p><b>narkose.ch</b> Riedhofstrasse 67 8408 Winterthur Tel.: 052 320 01 20 info-winterthur@narkose.ch</p>	<p><b>narkose.ch</b> Via Senago 42 6912 Lugano-Pazzallo Tel.: 091 980 44 04 info-ticino@narkose.ch</p>
<p><b>Limmatklinik</b> Hardturmstrasse 133 8005 Zürich Tel.: 044 448 30 30 info@limmatklinik.ch</p>		